

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Monitorimi i procesit zgjedhor: Kryetarja Krasniqi takim me vëzhguesit parazgjedhorë të Asamblesë Parlamentare të KE-së


Asambleja e 11-të e BRAF, kryetarja Krasniqi prezanton punën dhe progresin e arritur gjatë 2024

Janë zhvilluar në Baku të Azerbajxhanit punimet e Asamblesë së 11-të të Forumit të Autoriteteve...



Fq. 2

DËRGO ANKESË PËR TIKTOK



Fq. 2

Kreu i misionit të vëzhguesve të OSBE/ODIHR në AMA, Krasniqi: Kemi marrë të gjitha masat që procesi i monitorimit të zgjedhjeve të shkojë siç duhet

Zgjedhjet e 11 majit 2025 ishin thelbi i takimit të Ambasadorit Z. Lamberto...

Në prag të fillimit të fushatës AMA i tërheq vëmendjen OSHMA-ve për respektimin e Kodit Zgjedhor

Më datë 11.04. 2025 filloi zyrtarisht fushata elektorale për votimet e 11 Majit...

ZGJEDHJET E 11 MAJIT



Fq. 2

MBULIMI MEDIATIK I FUSHATËS NGA OSHMA



Fq. 3

Roli i medias në krijimin e një shoqërie të ndërgjegjshme, Sekretarja e Përgjithshme e AMA-s në samitin e organizuar nga RTUK

Sekretarja e Përgjithshme e AMA-s, Znj. Ronelda Rrapollari mori pjesë në samitin e organizuar nga Këshilli Suprem i Radios dhe Televizionit Turk...

Monitorimi i procesit zgjedhor: Kryetarja Krasniqi takim me vëzhguesit parazgjedhorë të Asamblesë Parlamentare të KE-së

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, znj. Armela Krasniqi, priti në një takim përfaqësuesit e misionit vëzhgues parazgjedhor të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Kryetarja Krasniqi i është përgjigjur interesit të vëzhguesve mbi angazhimin e AMA-s në monitorimin e procesit zgjedhor.

[Lexo më shumë](#)



Asambleja e 11-të e BRAF, kryetarja Krasniqi prezanton punën dhe progresin e arritur gjatë 2024

Janë zhvilluar në Baku të Azerbajxhanit punimet e Asamblesë së 11-të të Forumit të Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve në Detin e Zi (BRAF). Kryetarja e AMA-s Znj. Krasniqi prezantoi punën dhe progresin e arritur gjatë 2024. Një nga temat kryesore të takimit ishte dhe mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme. [Lexo më shumë](#)



Kreu i misionit të vëzhguesve të OSBE/ODIHR në AMA, Krasniqi: Kemi marrë të gjitha masat që procesi i monitorimit të zgjedhjeve të shkojë siç duhet

Zgjedhjet e 11 majit 2025 ishin thelbi i takimit të Ambasadorit Z. Lamberto Zannier, shef i misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve të 11 Majit dhe analistes se mediave, Znj. Elma Sehalić me kryetaren e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi. Znj. Krasniqi siguroi përfaqësuesit e lartë të OSBE se janë marrë të gjitha masat e nevojshme që procesi i monitorimit të zgjedhjeve të shkojë siç duhet. Në këtë kuadër në AMA mbërrit dhe delegacioni i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së i cili u prit nga Sekretarja e Përgjithshme e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe drejtues të lartë të institucionit.

[Lexo më shumë](#)

Roli i medias në krijimin e një shoqërie të ndërgjegjshme, Sekretarja e Përgjithshme e AMA-s në samitin e organizuar nga RTUK



Sekretarja e Përgjithshme e AMA-s, Znj. Ronelda Rrapollari mori pjesë në samitin e organizuar nga Këshilli Suprem i Radios dhe Televizionit Turk, (RTUK), në Ankara. Në thelb të tij ishte forcimi i medias dhe roli i saj në krijimin e një shoqërie të ndërgjegjshme. Znj. Rrapollari ka bërë një prezantim të gjendjes së medias sot, fenomeneve negative që ka nxjerrë në pah zhvillimi i teknologjisë, efekteve që ato kanë në publik dhe i është përgjigjur interesit të të pranishmeve me zgjidhjet e mundshme për pastrimin e hapësirave virtuale, dhe jo vetëm, nga përmbajtjet e dëmshme mediatiqe.

[Lexo më shumë](#)




Në prag të fillimit të fushatës AMA i tërheq vëmendjen OSHMA-ve për respektimin e Kodit Zgjedhor

Më datë 11.04. 2025 filloi zyrtarisht fushata elektorale për votimet e 11 Majit. Në këtë proces shumë të rëndësishëm 1-mujor do të përfshihen dhe OSHMA-të, duke bërë pjesë të programacionit të tyre mbulimin e dinamikës së garës mes subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre në çdo cep të vendit. Ndërkaq AMA u ka kërkuar OSHMA-ve të jenë korrekt duke respektuar kërkesat e Kodin Zgjedhor gjatë fushatës elektorale.

[Lexo më shumë](#)

Zbatimi i Aktit European për Lirinë e Medias: Ristrukturohet Grupi i Rregullatorëve Europeanë për Shërbimet Mediatike. Shqipëria ruan vendin si vëzhguese

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ka marrë pjesë në seancën plenare të radhës, të Grupit të Rregullatorëve Europeanë për Shërbimet Mediatike. Ky takim shënoi një hap vendimtar drejt konsolidimit institucional të Bordit të Medias për Shërbimet Mediatike (EBMS), ose ndryshe tranzicionit nga ERGA në strukturën e re të qeverisjes, EBMS, në kuadër të zbatimit të Aktit European për Lirinë e Medias. Shqipëria e ruan vendin e saj si vëzhguese në EBMS, edhe pas transformimit të këtij rrjeti europian. [Lexo më shumë](#)



Monitorimi i përmbajtjeve, lajmet politike zënë vendin kryesor në edicionet informative

Muaji mars ka prodhuar më shumë lajme politike për mediat audiovizive. Siç tregojnë të dhënat e përlogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në AMA pas politikës me 26.94%, vijnë lajmet ndërkombëtare me 12.40%, të ndjekura nga ato sociale me 11.18%.

[Lexo më shumë](#)

